



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr. 738/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashitresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Zyhdë Haziri anëtar, me pjesëmarrjen e Zyrtarit të Lartë Ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me apelet e parashtruara nga Mirlinda Gashi, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Malishevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur më datë 12.11.2017, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohen si të bazuara apelet e Mirlinda Gashi, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Malishevë, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) me numër 2232-2017 të datës 08.11.2017 pas shpalljes së rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Anëtarët e Kuvendit Komunal të mbajtura më datë 22.10.2017

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet e kandidatëve për anëtarë të Kuvendit Komunal në Malishevë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë, për vendvotimet: 3031A/01R, 3031A/02D, 3016A/01R, 3034A/01D, 3034A/02D

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve nga kutit e votimeve për Vendvotimet si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 09.11.2017 ka pranuar 3 apele ZL Anr. 738/2017, ZL Anr. 739/2017, dhe ZL Anr. 740/2017, të parashtruara nga Mirlinda Gashi, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Malishevë, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në

Malishevë, me të cilën kërkon që të bëhet rinumërimi i votave me arsyetimin se në vendvotimet 3031A/01R, 3031A/02D, 3016A/01R, 3034A/01D, 3034A/02D i mungojnë votat e saj dhe se të njëjtat i janë manipuluar.

Parashtruesja e apelit kërkon nga PZAP-i që këto apele të pranohen si të bazuar dhe të vërtetohet gjendja e saktë faktike. Si prova materiale ka bashkangjitur formularët e rezultateve të kandidateve për vendvotimet e lartcekura.

Paneli i PZAP-it, në bazë të nenit 13.2 të Rregullave dhe Procedurat e PZAP-it, ka bashkuar apelet dhe i ka trajtuar si një apel të evidentuar me ZL Anr. 738/2017, për shkak të natyrës së njëjtë të rasteve dhe pretendimeve ankimore, dhe për të gjitha ankesat vendosi me një vendim, për shkak të efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i shqyrtoj pretendimet ankimore dhe shkresat e tjera si dhe pas vlerësimit të gjithanshëm të tyre gjeti se:

apelet janë të bazuara

Paneli gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara, për faktin se pas shqyrtimit të provave dhe shkresave të lëndës si dhe dëshmive të ofruara nga ankuesi që gjenden në shkresat e lëndës dhe nga hetimi i bërë në materialin zgjedhor ka konstatuar se ka mospërputhje të rezultateve të shpallura nga vendimi i KQZ-së me Formularët e Rezultateve të Kandidatëve dhe Formularit Përfundimtar të Rezultatit për vendvotimet e lartcekura si më lart, andaj mbi këtë bazë dhe në mbështetje të nenit 117.4 të LZP-së, PZAP-i urdhëron KQZ-në që të bëhet rinumërimi i të gjitha fletëvotimeve për kandidatët për anëtarë të Kuvendit Komunal në Malishevë nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Malishevë për vendvotimet e lartcekura, ashtu që rezultati i dal nga ky rinumërim ti bashkëngjitet rezultatit përfundimtar.

Prandaj më qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze* po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

ZL.A.nr. 738/2017 me datën 12.11.2017



Këshillë Juridike: Ndaj këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa.